

05 4057
6 30.04.25
PRISHTINË / A No.2



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Mjedisit , Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry Environment Spatial Planning end Infrastucture

Departamenti i Menaxhimit të Rrugëve
Department of Road Management/ Departman za Upravljanje Puteva

DATE/A:	30.04.2025 NR 526
PËR/ZA/TO:	Via shpk, Eurokos shpk, Ferizaj, Prishtinë
CC:	z.Jeton Rexhepi - Policia e Kosovës MI Info
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z.Izedin Bytyqi, Sekretar i Pergjitheshem,u.d.-MMPHI
NGA/OD/FROM:	Qamil Feka, Drejtor, z.v. Departamenti i Menaxhimit të Rrugëve-MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për mbyllje të përkohshme të qarkullimit të rrugës R311, Hani i Elezit - Gorancë

I nderuar

-Kompania "VIA" SH.P.K &"EUROKOS" SH.P.K , Kontraktor (Konsorcium) në projektin
"Sanimi I rreshqitezës ne rrugen Hani I Elezit – Gorance" me nr prokurimi 209-19-5574-
5-1-1.

Për shkak të zhvillimit të punimeve të gërmimit në skarpatën e malit, në segmentin rrugor të rrëshqitëzës përgjatë rrugës Han i Elezit – Gorancë (R311), është vlerësuar se natyra dhe intensiteti i këtyre punimeve paraqet rrezik të lartë për sigurinë e pjesëmarrësve në trafik. Qarkullimi i automjeteve të çdo lloji kategorie, si dhe i këmbësorëve në këtë zonë gjatë kohës së kryerjes së punimeve, do të ishte i pasigurt dhe mund të sjellë pasoja serioze për jetën dhe pronën. Për rrjedhojë, në këto rrethana është e domosdoshme që rruga të mbyllet përkohësisht gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të punimeve në skarpatë që parashihet të jetë deri më 15.07.2025. Gjatë kësaj kohe, qarkullimi do të devijohet në një rrugë alternative, e cila është paraqitur nga kompania në hartën përkatëse. Kjo rrugë mund të shërbejë si një zgjidhje e përkohshme e cila është pjesërisht e shtruar me asfalt dhe pjesërisht me zhavorr, duke garantuar një nivel të pranueshëm sigurie dhe funksionaliteti për lëvizjen e automjeteve. Masat e ndërmarra janë të nevojshme për të siguruar mbarëvajtjen e punimeve dhe për të mbrojtur jetën dhe sigurinë e të gjithë përdoruesve të rrugës. Detaje të tjera janë të paraqitura edhe në Planin e Menaxhimit të Trafikut për mbylljen e përkohshme të rrugës Regjionale R311.

Aprovohet!

Nuk Aprovohet!

**EUROKOS**

Reference:				
Drejtuar:	Ministritë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktures			
Për:	Menaxheri Projektit: Ing. Lahudin Myrtaj			
Nga:	"VIA" shpk & "EUROKOS" shpk Ferizaj-Prishtinë			
Tema:	Kerkese per mbyllje të përkohshme qarkullimit të rruges R311 Hani Elezit - Gorancë			
Shërbimi:	Komunikimi:	044707009 – info@via-ks.com	Data:	23.04.2025

KERKESE

Kompania "VIA" SH.P.K & "EUROKOS" SH.P.K si Kontraktor (Konsorcium) në projektin "Sanimi i rreshqitëzës në rrugën Hani i Elezit – Gorancë" me nr prokurimi 209-19-5574-5-1-1. Për shkak të zhvillimit të punimeve të gërmimit në skarpatën e malit, në segmentin rrugor të rrëshqitëzës përgjatë rrugës Hani i Elezit – Gorancë (R311), është vlerësuar se natyra dhe intensiteti i këtyre punimeve paraqet rrezik të lartë për sigurinë e pjesëmarrësve në trafik. Qarkullimi i automjeteve të çdo lloji kategorie, si dhe i këmbësorëve në këtë zonë gjatë kohës së kryerjes së punimeve, do të ishte i pasigurt dhe mund të sjellë pasoja serioze për jetën dhe pronën.

Për rrjedhojë, në këto rrethana është e domosdoshme që rruga të mbyllet përkohësisht gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të punimeve në skarpatë që parashihet të jetë deri më 15.07.2025. Gjatë kësaj kohe, qarkullimi do të devijohet në një rrugë alternative, e cila është paraqitur në hartën përkatëse. Kjo rrugë përmbush kushtet teknike për të shërbyer si një zgjidhje e përkohshme dhe është pjesërisht e shtruar me asfalt dhe pjesërisht me zhavorr, duke garantuar një nivel të pranueshëm sigurie dhe funksionaliteti për lëvizjen e automjeteve.

Masat e ndërmarra janë të nevojshme për të siguruar mbarëvajtjen e punimeve dhe për të mbrojtur jetën dhe sigurinë e të gjithë përdoruesve të rrugës.

Detaje të tjera janë të paraqitura në Planin e Menaxhimit të Trafikut për mbylljen e përkohshme të rrugës Regjionale R311.

Me respekt,

"VIA" SH.P.K & "EUROKOS" SH.P.K

Drilon Shamolli



APROVUAR NGA

ME NAXHERI: LAHUDIN MYRTAJ



PLANI I MENAXHIMIT TË TRAFIKUT PËR MBYLLJEN E PÛRKOHSHME TË RRUGËS REGJIONALE R311

1. Qëllimi:

Qëllimi i këtij plani të menaxhimit të trafikut është të sigurojë menaxhim të sigurt dhe efikas të trafikut gjatë mbylljes së përkohshme të segmentit rrugorë dhe garantimin e sigurisë së përdoruesve të rrugës dhe punëtorëve. Për shkak të zhvillimit të punimeve të gërmimit në skarpatën e malit, në segmentin rrugor të rrëshqitëzës përgjatë rrugës Han i Elezit – Gorancë (R311), është vlerësuar se natyra dhe intensiteti i këtyre punimeve paraqet rrezik të lartë për sigurinë e pjesëmarrësve në trafik. Qarkullimi i automjeteve të çdo lloji kategorie, si dhe i këmbësorëve në këtë zonë gjatë kohës së kryerjes së punimeve, do të ishte i pasigurt dhe mund të sjellë pasoja serioze për jetën dhe pronën.

Për rrjedhojë, në këto rrethana është e domosdoshme që rruga të mbyllet përkohësisht gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të punimeve në skarpatë. Gjatë kësaj kohe, qarkullimi do të devijohet në një rrugë alternative, e cila është paraqitur në hartën përkatëse. Kjo rrugë përmbush kushtet teknike për të shërbyer si një zgjidhje e përkohshme dhe është pjesërisht e shtruar me asfalt dhe pjesërisht me zhavorr, duke garantuar një nivel të pranueshëm sigurie dhe funksionaliteti për lëvizjen e automjeteve.

Masat e ndërmarra janë të nevojshme për të siguruar mbarëvajtjen e punimeve dhe për të mbrojtur jetën dhe sigurinë e të gjithë përdoruesve të rrugës.

2. Detajet e mbylljes:

- **Rruga do të mbyllet:** Rruga regjionale R311 (Han i Elezit-Gilboçicë) nga kilometri 3+500 deri në kilometrin 4+500, përkatësisht segmenti ndërmjet rr.Ismail Qemajli deri në rr.Jatakët e lirisë.
- **Datat dhe orët e mbylljes:** nga momenti i aprovimit deri me datë 15.07.2025

3. Rrugët alternative:

- **Rruga alternative:** Lidhja mes rrugëve "28 Nëntori", "29 Gushti", "Sharri", dhe "Jatakët e Lirisë"
- **Shenjat e Paralajmërimit Paraprak:** Instalimi i tabelave paralajmëruese paraprake në kryqëzimet kryesore për të drejtuar shoferët drejt rrugëve alternative.

4. Masat e kontrollit të trafikut:

- **Barrikadat dhe sinjalistika:** Vendosja e barrikadave dhe sinjalistikës në vende të përshtatshme për të informuar shoferët për mbylljen e rrugës dhe për t'i ridrejtuar ata në rrugë alternative.
- **Flamurtarët/Personeli:** Caktimi i personelit të trajnuar për të drejtuar trafikun, për të ndihmuar këmbësorët dhe për të menaxhuar kryqëzimet gjatë orëve të pikut të trafikut.
- **Konet e trafikut:** Përdorimi i koneve të trafikut për të përcaktuar segmentin e rrugës së mbyllur dhe për të krijuar një ndarje të qartë midis trafikut të automjeteve dhe këmbësorëve.

5. Qasja e urgjencës:

- **Qasje emergjente me automjete:** Rruga alternative qëndron në dispozicion për çdo lloj emergjence.
- **Informacioni i kontaktit të urgjencës:** Meqë do të informohen të gjitha palët e afektuara, insti

tucionet publike të emergjencës do të menaxhojnë me çështjet emergjente.

6. Komunikimi dhe njoftimet:

- **Njoftim publik:** Njoftohen banorët, bizneset dhe udhëtarët për mbylljen e rrugës përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit si media lokale, media sociale sipas këshillave nga autoritetet publike.

7. Monitorimi dhe zbatimi:

- **Monitorimi:** Monitorimi i rregullt i zonës së mbylljes për të siguruar përputhjen me planin e menaxhimit të trafikut dhe për të adresuar menjëherë çdo çështje.

- **Zbatimi:** Koordinimi me agjencitë lokale të zbatimit të ligjit për të zbatuar rregullat e trafikut dhe për të garantuar sigurinë e punëtorëve dhe përdoruesve të rrugës.


8. Heqja e masave mbyllëse:

- **Largimi i planifikuar:** Procesi i heqjes së barrikadave, sinjalistikës dhe masave të tjera mbyllëse menjëherë do të kryhet menjëherë pas përfundimit të periudhës së mbylljes.


- **Inspektimi i pastrimit:** Inspektim i plotë i zonës së mbylljes për t'u siguruar që është e pastër nga mbeturinat ose rreziqet përpara se të rihapet për trafik.

Më poshtë gjeni të gjitha lokacionet dhe shenjëzimet e nevojshme.

Trimor Rexhepi
(Inxhinier i komunikacionit)


23.04.2025



Via sh.p.k
Drilon Shamolli
(Drejtore)


23.04.2025




Druga alternative

Druga Regjionale R311



1

2



3

4

5



1	PLANI MENAXHIMIT TË TRAFIKUT NË DEVLIMIN E RRUGËS Regjionale R311, SEGMENTI HANI I ELEZIT-GLOBOÇIC	
	PUNËKRYESI	VULA
DATA 22.04.2025		






Image © 2025 Airbus

Rruga alternative
 Rruga Regjionale R311



1

2



3

4



6

5

2	PLANI MENAXHIMIT TË TRAFIKUT NË DEVIJIMIN E RRUGËS Regjionale R311, SEGMENTI HANI I ELEZIT-GLOBOCIC	
	PUNËKRYESI	VULA
DATA 22.04.2025		